



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Nr: KSC-CC-2019-07

Vendos: **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**
Gjykatës Vidar Stensland, Kryetar
Gjykatës Roland Dekers
Gjykatës Antonio Balsamo

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrës parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 2 dhjetor 2019

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës referuese të z. Driton Lajçi drejtuar panelit të Gjykatës Kushtetuese mbi ligjshmërinë e procedurës së marrjes në pyetje me shtojcat konfidenciale 1-3

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësi i Specializuar për z.

Driton Lajçi

Z. Tobi Kadman

I. HYRJE

1. Kërkesa referuese¹ e z. Driton Lajçi ('Parashtruesi') duhet të hidhet poshtë menjëherë. Ajo është e papranueshme dhe e pabazë. Konkretisht, parashtruesi nuk shfrytëzoi të gjitha mjetet juridike në dispozicion para se të dorëzonte për protokollim kërkesën referuese. Ai është i detyruar ta bëjë këtë para se Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese ('Gjykata Kushtetuese') të shqyrtojë çështjen. Sa u përket arsyeve ku bazohet kërkesa, parashtruesi keqinterpreton si kornizën ligjore në fuqi, po ashtu edhe faktet. Parashtruesit iu dha informacion i mjaftueshëm dhe ai nuk ka provuar se ekziston paragjykim ndaj drejtësisë së një procesi gjyqësor në të ardhmen, nëse do të ketë një të tillë.

II. HISTORIKU PROCEDURAL

2. Më 25 shtator 2019, Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') lëshoi një fletëthirrje që parashtruesi të paraqitej për marrje në pyetje, në Hagë, më 17-18 tetor 2019.²
3. Në mbremjen e 13 tetorit 2019, mbrojtësi i parashtruesit i dërgoi një letër ZPS-së,³ së cilës ZPS-ja iu përgjigj më 14 tetor 2019.⁴
4. Më 17 tetor 2019, ZPS-ja kreu intervistën sipas ligjit ('Intervista').⁵
5. Më 13 nëntor 2019, parashtruesi i paraqiti Gjykatës Kushtetuese kërkesën referuese.⁶
6. Më 15 nëntor 2019, Kryetarja e Dhomave të Specializuara lëshoi një vendim, në bazë të nenit 33(3) të Ligjit, me anët të të cilit caktoi panelin e Gjykatës Kushtetuese

¹ Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Ligjshmërinë e Procedurës së Marrjes në Pyetje, KSC-CC-2019-07/F00001, 13 nëntor 2019, shpërndarë më 14 nëntor 2019 ('Kërkesa Referuese').

² Shtojca 1 (fletëthirrje me datën 25 shtator 2019).

³ Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, Shtojca 1.

⁴ Shtojca 2 (mesazh elektronik nga ZPS-ja dërguar mbrojtësit të parashtruesit me datë 14 tetor 2019 në orën 16:43).

⁵ Shtojca 3 (Transkript i intervistës me datë 17 tetor 2019, në pjesët 1 dhe 2).

⁶ Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001.

për të vendosur në lidhje me kërkesën referuese ('Paneli').⁷ Paneli caktoi anglishten si gjuhën e punës së kërkesës referuese.⁸

7. Më 18 nëntor 2019, duke vepruar në bazë të rregullës 15(2) të Rregullores,⁹ paneli ftoi ZPS-në që, nëse dëshironte, mund të paraqiste parashtrim në lidhje me kërkesën referuese, më 2 dhjetor 2019 ose para kësaj date.¹⁰

III. ARGUMENTET

8. Kërkesa referuese është *prima facie* e papranueshme. Parashtruesi (i) nuk ka shfrytëzuar të gjitha mjete e disponueshme juridike,¹¹ (ii) nuk ka identifikuar konkretisht vendimin që kundërshton, as dispozitën ose dispozitat kushtetuese që pretendon se janë shkelur,¹² dhe (iii) ka kërkuar që paneli të shqyrtojë çështje për të cilat paneli nuk ka juridiksion¹³ dhe/ose për të cilat parashtruesi nuk është i autorizuar që të paraqesë kërkesë referuese.¹⁴ Është domethënës fakti se parashtruesi madje as ka bërë përpjekje për të provuar pranueshmërinë e kërkesës referuese.

9. Gjithashtu, kërkesa referuese duhet të hidhet poshtë sepse është e pabazuar, duke qenë se (i) parashtruesi keqinterpretonte kornizën ligjore për dhënien e informacionit të dyshuarve dhe të akuzuarve, sikurse parashihet në Ligj,¹⁵ në

⁷ Vendim për caktimin e gjykatësve në një panel të Gjykatës Kushtetuese, KSC-CC-2019-07/F00002, 15 nëntor 2019.

⁸ Vendim mbi gjuhën e punës, KSC-CC-2019-07/F00005, 18 Nëntor 2019, shpërndarë më 19 nëntor 2019.

⁹ Rregullorja e Punës për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, KSC-BD-03/Rev1/2017, 21 korrik 2017 ('Rregullorja').

¹⁰ Njoftim në lidhje me parashtrimin e kundërpërgjigjes, KSC-CC-2019-07/F00006, 18 nëntor 2019, shpërndarë më 19 nëntor 2019, para.5.

¹¹ Shih nenin 113(7) të Kushtetutës, nenin 49(3) të Ligjit dhe rregullën 20(1) të Rregullores.

¹² Shih rregullën 14(c) të Rregullores.

¹³ Shih rregullën 14(a) të Rregullores. Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para 4.3 (ku parashtrohen argumente të parakohshme në lidhje me pranueshmërinë e intervistës) dhe 5.1 (parashtrohet se procedurat e ZPS-së nuk janë në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren e DHSK-së, që nuk është çështje e interpretimit të Kushtetutës ose kushtetutshmërisë).

¹⁴ Shih nenin 113(7) të Kushtetutës, nenin 49(3) të Ligjit dhe rregullën 20(1) të Rregullores. Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para 4.4 dhe 5.1 (kërkohet që paneli të shqyrtojë kushtetutshmërinë e Ligjit).

¹⁵ Ligji nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji').

Rregulloren e DHSK-së,¹⁶ në Kushtetutën e Republikës së Kosovës ('Kushtetuta') dhe të drejtat përkatëse të njeriut, (ii) informacioni që i është dhënë parashtruesit në këtë rast i tejkaloi ato kushte, dhe (iii) parashtruesi nuk ka provuar së është paragjykuar e drejta e tij për një gjykim të drejtë.

A. KËRKESA REFERUESE ËSHTË E PAPRANUESHME

10. Gjykata Kushtetuese mund të vendosë vetëm për çështje që palët e autorizuara i referojnë kësaj gjykate në mënyrë ligjore.¹⁷ Në bazë të nenit 49(3) të Ligjit dhe nenit 113(7) të Kushtetutës, individët janë të autorizuar t'i drejtohen Gjykatën Kushtetuese vetëm pasi të jenë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara prej ligjit. Kriteri i shfrytëzimit të të gjitha mjeteve juridike nuk është thjesht një formalitet procedural. Ky kriter mundëson një proces procedural me rend, parandalon shfrytëzimin e njëkohshëm paralel të mjeteve juridike, ruan të drejtën e apelit dhe mundëson që Gjykata Kushtetuese të shqyrtojë vetëm ato çështje që është e nevojshme t'u kushtojë vëmendje dhe për këtë bazohet në një dokumentacion të krijuar në mënyrën e duhur.¹⁸

11. Në Rregullore shtjellohet konkretisht kriteri i shfrytëzimit të të gjitha mjeteve juridike që përcakton se, para se një individ t'i paraqesë kërkesë referuese Gjykatës Kushtetuese:

¹⁶ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev1/2017, 5 korrik 2017 ('Rregullorja e DHSK-së').

¹⁷ Kushtetuta, Neni.113(1); Ligji, Neni.49(2) dhe (3); Rregullorja, rregullat 4 dhe 20.

¹⁸ *Shih, për shembull*, GJKK, Lënda nr. KI 08/11, *Parashtrues Malush Sopa, Sedat Kuqi, Fazli Morina, Rrahman Kabashi and Liman Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, 24 prill 2012, para 46-49; GJKK, Lënda nr. KI 58/13, *Parashtrues Sadik Bislimi*, Aktvendim për Papranueshmëri, 25 nëntor 2013, para 28-32 ('çdo herë që pretendohet shkelja e të drejtave të njeriut, ky pretendim nuk mund të arrijë në Gjykatën Kushtetuese para se të shqyrtohet në gjykatat e rregullta' (para.31)); GJKK, Lënda nr. KI 17/13, *Parashtrues Bujar Bukoshi*, Vendim mbi Kërkesën për Masa të Përkohshme, 14 mars 2013, para 27-28; GJKK, Lënda nr. KI 102/16, *Parashtrues Shefqet Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri, 2 mars 2017, para 41-43; GJKK, Lënda nr. KI 23/10, *Parashtrues Jovica Gadžić*, Aktvendim për Papranueshmëri, 19 shtator 2013, para 47-49; GJKK, Lënda nr. KI 07/13, *Parashtrues Ibish Kastrati*, Aktvendim për Papranueshmëri, 5 korrik 2013, para 25-29; GJKK, Lënda nr. KI.94/17, *Parashtrues Muhamedali Čeşülmedine*, Aktvendim për Papranueshmëri, 27 prill 2018, para.40; GJKK, KI.41/09, *Parashtrues AAB-RIINVEST University LLC*, Aktvendim, 27 janar 2010, para 16-17, *citon ECtHR, Selmouni v. France*, no. 25803/94, 28 korrik 1999.

- (i) duhet të jenë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike të efektshme që parashikon ligji në lidhje me shkeljen e pretenduar; dhe
- (ii) kërkesa referuese duhet të dorëzohet brenda dy (2) muajsh nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar në lidhje me shkeljen e pretenduar.¹⁹

12. Asnjë prej këtyre kushteve nuk është përmbushur në rastin konkret e parashtruesi as nuk është përpjekur të pretendojë përmbushjen e tyre. Vetëm për këtë arsye, kërkesa referuese duhet rrëzuar.

13. Ekzistojnë mjete juridike alternative të cilat nuk janë shfrytëzuar. Korniza ligjore e Dhomave të Specializuara ofron mjete juridike dhe garanci konkrete, të përdorshme dhe të efektshme të cilat trajtojnë ankesën e parashtruesit përmes gjykatave të shkallëve më të ulëta. Neni 39(1) dhe (3) I Ligjit e autorizon gjykatësin e procedurës paraprake, ose gjykatësin e vetëm të emëruar sipas neneve 25(1)(f) dhe 33(2) të Ligjit, që të lëshojë urdhra ose vendime të nevojshme për kryerjen e hetimit dhe përgatitjen e procedurave të drejta dhe të shpejta. Konkretisht në nenin 39(10) të Ligjit përcaktohet se personi që paraqitet në bazë të një fletëthirrjeje mund t'i bëjë kërkesë gjykatësit të procedurës paraprake ose gjykatësit të vetëm që të nxjerrë urdhra që mund të jenë të nevojshëm për ta ndihmuar atë person të përgatisë mbrojtjen e vet. Këto dispozita përforcohen prej rregullës 48(2) të Rregullores së DHSK-së e cila i mundëson një të dyshuari që të bëjë kërkesë për lëshimin e një vendimi të nevojshëm për hetimin ose përgatitjen dhe kryerjen e procedurave gjyqësore. Shihet qartë se kjo kornizë ligjore u krijua që t'i mundësonte gjykatësit të procedurës paraprake ose gjykatësit të vetëm që të trajtonin çështje që dalin gjatë kryerjes së hetimit, ku përfshihen çështje lidhur me të drejtat e personave të thirrur nga ZPS-së, sikurse parashtruesi.

14. Rrjedhimisht çështjet që ngrihen në kërkesën referuese janë drejtpërsëdrejti brenda kompetencës dhe juridiksionit të gjykatësit të procedurës paraprake ose gjykatësit të vetëm. Këto mjete duhet të shfrytëzohen para se çështja të merret në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese.

¹⁹ Rregullorja, rregulla 20(1).

15. Parashtruesi nuk ka ndërmarrë asnjë hap që të përdorë mjete në bazë të këtyre dispozitave, as ka ofruar arsye për këtë mosveprim. Në qoftë se do të kishte paraqitur një kërkesë të tillë, ai do të kishte pasur mundësinë që argumentet e tij të dëgjoheshin dhe vlerësoheshin prej gjykatësit të procedurës paraprake ose gjykatësit të vetëm përmes procedurës së zakonshme. Në lidhje me këtë, nuk është lëshuar asnjë vendim përfundimtar brenda kuptimit të rregullës 20 të Rregullores për asnjë nga çështjet e ngritura në kërkesën referuese. Parashtruesi nuk ka identifikuar asnjë vendim të tillë dhe nuk ka ndërmarrë asnjë nga hapat e kërkuar për lëshimin e një vendimi të tillë.

16. Për më tepër, kërkesa referuese i referohet në mënyrë të përgjithësuar Kushtetutës,²⁰ e askund nuk identifikon dispozitën ose dispozitat kushtetuese konkrete që pretendohet të jenë shkelur. ZPS-ja mendon se në fund të fundit kërkesa referuese kryesisht përqendrohet në të drejtën e parashtruesit për një gjykim të drejtë.²¹ Sidoqoftë, në kërkesën referuese ceken një sërë çështjesh të cilat nuk kanë lidhje me Kushtetutën, dhe për të cilat paneli nuk ka juridiksionin, ku përfshihen thjesht pajtueshmëria e praktikave të ZPS-ë me Ligjin dhe Rregulloren e DHSK-së,²² dhe argumente abstrakte dhe të parakohshme lidhur me pranueshmërinë e provave.²³ Gjithashtu duket se në kërkesë referuese kërkohet që paneli të shqyrtojë kushtetutshmërinë e Ligjit dhe Rregullores së DHSK-së,²⁴ çështje për të cilën një individ nuk është i autorizuar që të paraqesë kërkesë referuese. Faktikisht, në bazë të parimit se pretendimet për shkelje duhet të shqyrtohen së pari nga gjykatat e shkallëve më të ulëta, janë gjykatësi ose paneli i procedurës paraprake që janë të autorizuar të bëjnë referime të tilla.²⁵

²⁰ *Shih p.sh.* Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para 1.2-1.4, 5.1, 5.5.

²¹ *Shih p.sh.* Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para 1.4(c), 3.9, 4.13, 4.15-4.17, 5.1-5.3 (i referohet të drejtave ndërkombëtare të njeriut, dhe konkretisht nenit 6 të Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut ('KEDNJ').

²² Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para 1.2-1.3 (kërkohet të merret vendim mbi ligjshmërinë e praktikave të ZPS-së si alternativë të një vendimi mbi kushtetutshmërinë e tyre), 1.4(b) dhe 5.1.

²³ Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para 4.3 dhe 4.22.

²⁴ Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para 4.4 dhe 5.1.

²⁵ *Krahaso* nenet 113(7) të Kushtetutës dhe 49(3) të Ligjit (që autorizojnë individët të bëjnë kërkesë referuese kur pretendojnë shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre individuale) me nenet 113(8) të

17. Bazuar në secilën prej arsyeve të lartpërmendura, paneli duhet ta hedhë poshtë menjëherë kërkesën referuese.

B. KËRKESA REFERUESE NUK KA BAZË

1. Parashtruesi ka keqinterpretuar kornizën ligjore në fuqi

18. Nuk është e nevojshme që Gjykata Kushtetuese të shqyrtojë bazën, mirëpo është e qartë se edhe në këtë pikë pretendimi i parashtruesit nuk ka bazë. Ligji dhe Rregullorja e DHSK-së ofrojnë një kornizë ligjore që është e pajtueshme me Kushtetutën dhe të drejtat njerëzore përkatëse. Në kornizën e lartpërmendur bëhet një dallim i qartë midis të dyshuarve të cilët kanë së paku të drejtat e përcaktuar në nenin 38 të Ligjit dhe të akuzuarve të cilët kanë të drejtat e përcaktuara në nenin 21 të Ligjit. Në kërkesën referuese këto dy kategori të dallueshme ngatërrohen pa asnjë bazë ligjore apo logjike.

19. Ndonëse nuk vihet në dyshim se garancitë për një gjykim të drejtë që përfshihen në nenin 6 të KEDNJ-së²⁶ zbatohen gjatë fazë hetimore ose të procedurës paraprake, konkretisht nga momenti kur personi është objekt i një 'akuze',²⁷ është e vetëkuptueshme se jo të gjitha të drejtat e nenit 6(3) të KEDNJ-së zbatohen plotësisht ose në disa raste nuk zbatohen aspak në fazën hetimore ose të procedurës paraprake.²⁸ Faktikisht, është arritur në përfundimin se këto të drejta *mund* të jenë relevante gjatë

Kushtetutës dhe 49(4) të Ligjit (që në rrethana të përshtatshme i rezervon panelit autoritetin për t'i parashtruar Gjykatës Kushtetuese çështje të kushtetutshmërisë së një ligji).

²⁶ *Shih gjithashtu* të drejtat për gjykim të drejtë të përcaktuara në nenin 30(1) të Kushtetutës dhe nenin 14(3)(a) të Marrëveshjes Ndërkombëtare për Të Drejtat Civile dhe Politike ('MNDCP').

²⁷ Në bazë të praktikës gjyqësore, një "akuzë penale" ekziston prej momentit kur një individ informohet zyrtarisht prej autoritetit kompetent se ekziston pretendim që ai ka kryer një vepër penale, ose që prej pikës në të cilën situata është ndikuar thelbësisht nga veprimet e ndërmarra nga autoritetet si rezultat i një dyshimi kundër tij (*Shih p.sh.* Gjykata Evropiane për Të Drejtat e Njeriut ('GJEDNJ'), *GC, Ibrahim and Others v. The United Kingdom*, nos 50541/08, 50571/08, 50573/08 and 40351/09, 13 shtator 2016 ('*Ibrahim and Others v. The United Kingdom*'), para.249). Këtu përfshihen edhe rrethanat në të cilat një person intervistohet si i dyshuar, sikurse parashtruesi (ECtHR, *Hozee v. The Netherlands*, 22 maj 1998, para 45-46).

²⁸ Më së qarti kjo mund të shihet për shembull në nenin 6(3)(d) të KEDNJ-së (ku ndër të tjera përcaktohet e drejta e një personi që t'u bëjë pyetje dëshmitarëve kundër tij, ose që këta dëshmitarë të merren në pyetje në emër të tij).

procedurës hetimore dhe asaj paraprake 'në qoftë se dhe për aq sa ka gjasa që drejtësia e gjyqimit të cenohet rëndë për arsye të mosrespektimit fillestar të këtyre të drejtave'.²⁹ Çka është e rëndësishme, të drejtat e përcaktuara në nenin 6(3) të KEDNJ-së nuk janë synime në vetvete, por për të kontribuar në drejtësinë e procedurave në tërësi.³⁰ Rrjedhimisht, në kundërshtim me përpjekjen e gabuar e parashtruesit që neni 21 i Ligjit, ose neni 6(3) i KEDNJ-së të lexohen brenda kontekstit të nenit 38 të Ligjit,³¹ mënyra e zbatimit të nenit 6(3) në fazën hetimore ndër të tjera varet nga veçoritë e procedurave në fjalë dhe rrethanat e rastit.³²

20. Qëllimi i nenit 6(3)(a) të KEDNJ-së është të mbrohet aftësia e një personi për përgatitjen e mbrojtjes së vet gjatë gjyqimit.³³ Ky qëllim nuk kërkon që prokuroria t'i bëjë të njohur çdo të dyshuari që merr në pyetje gjatë fazës hetimore objektive e saj hetimore ose provat. Kundër shumicës së të dyshuarve nuk do të ngrihet aktakuzë dhe të gjithë të dyshuarit kanë të drejtën që të mos i përgjigjen asnjë prej pyetjeve të prokurorisë, ose kanë të drejtë të këshillohen me mbrojtësin e tyre para se t'i përgjigjen një pyetjeje. E drejta për të mbajtur heshtje dhe për të pasur mbrojtës mbron plotësisht të drejtat e të dyshuarit gjatë intervistës.

21. Dallimi midis fazës hetimore dhe asaj të gjyqimit gjithashtu është njohur nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Njeriut ('KDNJ') në interpretimin e dispozitave të barasvlershme në MNDP.³⁴ Po ashtu, Dhomat Gjyqësore të

²⁹ *Shih p.sh. Ibrahim and Others v. The United Kingdom*, para.253; ECtHR, *Imbroscia v. Switzerland*, 13972/88, 24 nëntor 1993, para.36.

³⁰ *Shih p.sh. Ibrahim and Others v. The United Kingdom*, para.251. *Shih gjithashtu* para.253 (theksohet se objektivi kryesor i nenit 6 të KEDNJ-së është garantimi i një gjykimi të drejtë).

³¹ *Shih p.sh. Kërkesa Referuese*, KSC-CC-2019-07/F00001, para 3.7-3.8, 4.2, 4.4, 4.19.

³² *Shih p.sh. Ibrahim and Others v. The United Kingdom*, para.253.

³³ ECtHR, GC, *Pélissier and Sassi v. France*, nr. 25444/94, 25 mars 1999 ('*Pélissier and Sassi v. France*'), para.52 (ku e drejta për t'u informuar lidhet me garantimin e drejtësisë së procedurave gjyqësore vijuese); ECtHR, *Mattoccia v. Italy*, no. 23969/94, 25 korrik 2000 ('*Mattoccia v. Italy*'), para.60. *Shih edhe* European Commission on Human Rights, *C. v. Italy*, no. 10889/84, 11 maj 1988, f.59 ('informacioni i marrë nga parashtruesi [...] u dha në kohën e duhur për përgatitjen e mbrojtjes së tij, gjë që është objektivi kryesor bazë i nenit 6 para.3(a) të Konventës. Ndonëse marrja e informacionit prej parashtruesit në një fazë më të hershme mund t'i kishte sjellë atij avantazhe, komisioni nuk konstaton asnjë shkelje të dukshme të nenit 6 para.3 (a) të Konventës').

³⁴ HRC, *Khachatryan v. Armenia*, no. 1056/2002, 28 tetor 2005, para.6.4. *Shih edhe* HRC *Evelio Ramon Gimenez v. Paraguay*, no. 2372/2014, 25 korrik 2018, para.7.10; HRC *Kelly v Jamaica*, 253/1987, 10 prill

Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ('TPNJ') kanë hedhur poshtë në mënyrë konsekuente përpjekjet për t'u bazuar tërësisht në fushëveprimin e nenit 14(3)(a) të MNDCP-së, në kontekstin e intervistave hetimore.³⁵

22. Vihet re se parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë burim ligjor të zbatueshëm në mbështetje të pretendimit se informimi me detaje për natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij kërkohet në momentin e lëshimit të fletëthirrjes për një intervistë hetimore, dhe/ose para nisjes së intervistës. Asnjë prej rasteve të GJEDNJ-së të cituara në kërkesën referuese nuk e mbështetet këtë pretendim.³⁶ Këto raste kanë të bëjnë me: (i) privilegjin kundër vetinkriminimit dhe të drejtën për ndihmë juridike gjatë intervistës si i dyshuar;³⁷ (ii) zbatueshmërinë e nenit 6(3)(a) të KEDNJ-së pas dorëzimit të aktakuzës dhe pak para nisjes së gjykimit;³⁸ dhe (3) ricilësimin e akuzave gjatë gjykimit.³⁹

23. Argumenti i parashtruesit se ai kishte të drejtë të vihej në dijeni të provave themelore që përbënin bazën e pretendimeve,⁴⁰ është tërësisht i pambështetur. Nuk është e mjaftueshme të deklarosh thjesht se dhënia e një informacioni të tillë do të kishte ndihmuar mbrojtësin në këshillimin e klientit të vet.⁴¹ Në fazën hetimore nuk

1991, para.5.8. HRC, General Comment no. 32, Article 14: E drejta e barazisë në gjykata dhe tribunale dhe e gjykimit të drejtë, 23 gusht 2007, CCPR/C/CG/32, para.31.

³⁵ TPNJ/ICTY, *Prokurori k. Haraqisë dhe Morinës/Prosecutor v. Haraqija and Morina*, IT-04-84-R77.4, Vendim mbi Kërkesën e Bajrush Morinës për Deklarim të Papranueshmërisë dhe Përjashtimin e Provave/Decision on Bajrush Morina's Request for a Declaration of Inadmissibility and Exclusion of Evidence, IT-04-84-R77.4, 28 gusht 2008, para.30; TPNJ/ICTY, *Prokurori k. Popoviçit dhe të tjerëve/Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Vendim mbi Pranueshmërinë e Intervistës së Borovčaninit dhe ndryshimin e listës së provave materiale sipas rregullës 65 ter/Decision on the Admissibility of the Borovčanin Interview and the amendment of the Rule 65 Ter Exhibit List, 25 tetor 2007, para.35.

³⁶ Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para.4.12 (i referohet *Ibrahim and Others v. The United Kingdom*), 4.16 (i referohet *Pélissier and Sassi v. France*), ECtHR, *Kamasinski v. Austria*, no. 9783/82, 19 dhjetor 1989 ('*Kamasinski v. Austria*'), 4.17 (i referohet *Mattoccia v. Italy*), ECtHR, *Penev v. Bulgaria*, no. 20494/04, 7 janar 2010 ('*Penev v. Bulgaria*').

³⁷ *Ibrahim and Others v. The United Kingdom*, para. 255-273, 294, 311, 315.

³⁸ *Kamasinski v. Austria*, para 78-81; *Mattoccia v. Italy*, para 58-72. Vlen të theksohet se në *Kamasinski v. Austria*, GJEDNJ-ja konstatoi se kur një të pandehuri i dorëzohet aktakuza, kjo shënon momentin kur ky i pandehur njoftohet zyrtarisht me shkrim për bazën faktike dhe ligjore të akuzave kundër tij (*Kamasinski v. Austria*, para.78).

³⁹ *Pélissier and Sassi v. France*, para 42-63; *Penev v. Bulgaria*, para.29.

⁴⁰ *Shih* Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para. 1.2-1.3, 4.2.

⁴¹ *Shih* Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para. 2.10.

ekziston e drejta për dhënien e një informacioni të tillë, e ky material madje as nuk përfshihet automatikisht brenda fushëveprimit të nenit 6(3)(a) të KEDNJ-së.⁴²

24. Parashtruesi bazohet kryesisht në Direktivën e Bashkimit Evropian 2012/13/EU,⁴³ e cila nuk është pjesë e kornizës ligjore të zbatueshme të Dhomave të Specializuara dhe rrjedhimisht nuk duhet të merret parasysh. Sido që të jetë, kjo direktivë bie ndesh me pikëpamjen e parashtruesit e nuk e mbështet atë. Ajo është një shembëllim i kornizës që përcaktohet në Ligj dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, duke theksuar se informacioni i kërkuar: (i) është informacioni ‘i nevojshëm për të garantuar drejtësinë e procedurës dhe ushtrim të efektshëm të të drejtave të dyshuarve ose të akuzuarve’,⁴⁴ (ii) varet nga faza e procedurës penale dhe konkretisht se fushëveprimi i plotë i obligimit qartësohet në momentin e paraqitjes së aktakuzës një gjykate;⁴⁵ dhe (iii) dhe dhënia e informacionit nuk duhet të paragjykojë rrjedhën e hetimeve në kryerje e sipër.⁴⁶ Rrjedhimisht, Direktiva nuk ofron asnjë bazë që mbështet orvatjen e parashtruesit në riinterpretimin e ekuilibrit të kujdesshëm të përcaktuar në Ligj dhe në Rregulloren e DHSK-së.

25. Zbatimi i një kornize ligjore që shpërfill dallimin midis fazës hetimore të zbulimit të fakteve dhe pikënisjes së gjykimit është i pazbatueshëm dhe i pamatur sepse në shumë raste: (i) do të paragjykonte rëndë kryerjen e hetimeve në kryerje e sipër; (ii) me gjasë do të krijonte rreziqe të papranueshme për sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarëve të cilët mund të identifikoheshin lehtësisht prej detajeve të pretendimit; dhe (iii) me gjasë do të rezultonte në cenimin dhe/ose asgjësimin e provave. Për më tepër, gjatë fazës hetimore, në procesin e zbardhjes së fakteve,

⁴² European Commission on Human Rights, *X v. Belgium*, no.7628/76, 9 maj 1977; European Commission on Human Rights, *Colozza and Rubinat v. Italy*, nos 9024/80 and 9317/81, 5 maj 1983. ‘Shkaku’ dhe ‘natyra’ e akuzave përfshijnë veprat e pretenduara dhe cilësimin ligjor e këtyre veprave (*Shih p.sh. Mattoccia v. Italy*, para. 59).

⁴³ Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para. 4.9, i referohet Direktivës 2012/13/EU të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, 22 maj 2012 (‘Direktivë e BE-së/EU Directive 2012/13’), para.28.

⁴⁴ EU Directive 2012/13, Neni.6(1). *Shih edhe* para.28.

⁴⁵ EU Directive 2012/13, Art.6(3). *Shih edhe* para.28 (‘duke marrë parasysh fazën e procedurës penale kur jepet përshkrimi’).

⁴⁶ EU Directive 2012/13, para.28.

prokuroria pikërisht përcakton akuzat zyrtare të mundshme dhe gjatë të gjithë kohës analizon e rianalizon provat ekzistuese. Në rrethana të tilla, informimi me detaje për natyrën dhe shkakun e akuzave e aq më tepër dhënia e informacionit për provat themelore që shërbejnë si bazë, jo vetëm që do të ishte e pamundshme, por edhe e panevojshme për përmbushjen e synimit parësor të nenit 6(3)(a) të KEDNJ-së, me fjalë të tjera për të mundësuar drejtësinë e procedurave të mundshme gjyqësore të ardhme.

2. Parashtruesit iu dha informacion i mjaftueshëm

26. Në këtë rast, natyra dhe koha e dhënies së informacionit për parashtruesin, i tejkaluan kriteret e kornizës ligjore të zbatueshme dhe ishin më se të mjaftueshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e të drejtave të tij për gjykim të drejtë.

27. Para intervistës, parashtruesi u informua me shkrim se ekzistonin arsye për të besuar se ai kishte kryer një vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.⁴⁷ Ky informacion iu dha me shkrim edhe mbrojtësit të parashtruesit para intervistës⁴⁸ dhe, informacioni i lartpërmendur së bashku me të drejtat e tjera të nenit 38(3) të Ligjit, iu shpjeguan gojarisht parashtruesit në fillim të intervistës, para se të fillonte marrja në pyetje.⁴⁹

28. Parashtruesi u informua me shkrim përmes mbrojtësit të tij para datës së intervistës,⁵⁰ dhe gojarisht në fillim të intervistës,⁵¹ për natyrën e hetimit që po kryhej duke përfshirë cilësimin konkret ligjor të veprave penale që po hetoheshin. Në lidhje me këtë pikë, kërkesa referuese shtrembëron në mënyrë të konsiderueshme faktet kur deklaroi se as parashtruesi as mbrojtësi i tij nuk u informuan për veprat penale

⁴⁷ Shtojca 1 (fletëthirrje me datë 25 shtator 2019).

⁴⁸ Shtojca 2 (Mesazh elektronik i ZPS-së dërguar mbrojtësit të parashtruesit me datë 14 tetor 2019 në orën 16:43).

⁴⁹ Shtojca 3 (Transkript i intervistës me datë 17 tetor 2019, Pjesa 1, f..2).

⁵⁰ Shtojca 2 (Mesazh elektronik i ZPS-së dërguar mbrojtësit të parashtruesit me datë 14 tetor 2019 në orën 16:43).

⁵¹ Shtojca 3 (Transkript i intervistës me datë 17 tetor 2019, Pjesa 1, f..2, rreshtat 13-20).

konkrete të pretenduara para nisjes së intervistës.⁵² Megjithëse nuk ishte e nevojshme,⁵³ ZPS-ja faktikisht i informoi ata.

29. Më tej, parashtruesi u informua në nisje të intervistës mbi natyrën e veprave të cilat ai pretendohet të ketë kryer.⁵⁴ Së fundi, parashtruesi gjithashtu u informua për temat të cilat ZPS-ja do të ngrinte gjatë intervistës dhe iu tha se do të lejohej të këshillohej me mbrojtësit e vet privatisht në lidhje cilëndo prej pyetjeve që do t'i bëheshin gjatë intervistës.⁵⁵

3. Parashtruesi nuk ka provuar se paragjykohej të drejtat e tij për gjykim të drejtë

30. Parashtruesi nuk ka mundur të provojë se në rast të procedurave gjyqësore të mundshme kundër tij, drejtësia e këtyre procedurave do të paragjykohej. Sikurse është theksuar më lart, parashtruesit iu dha informacion i mjaftueshëm me qëllim që të merrte një vendim të bazuar mbi atë informacion lidhur me ushtrimin e të drejtave të tij gjatë intervistës dhe, në fakt, ai i ushtroi plotësisht të gjitha të drejtat që i takonin, përfshirë edhe këshillimin me dy mbrojtësit e specializuar dhe të drejtën e mbajtjes së heshtjes. Edhe në rast se kundër tij do të ngriheshin akuza, ndaj tij nuk do të shkaktohej asnjë paragjykim për shkak të ushtrimit të së drejtës së heshtjes, meqenëse kjo nuk është një çështje që mund të shqyrtohet në vendimet e mundshme të fajësisë apo pafajësisë së tij në të ardhmen.

⁵² Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para.1.3(a). *Shih gjithashtu* Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para.2.17 (ku pasaktësisht dhe duke shtrembëruar faktet deklarohet se ZPS-ja nuk kishte dhënë 'informacion para intervistës').

⁵³ Shih Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para.2.11 (ku nxirret një deduksion i pasaktë nga fakti se ZPS-ja e dha këtë informacion në përgjigje të kërkesës së mbrojtësit). Në kundërshtim me pretendimin e parashtruesit se një informacion i tillë duhej të ishte përfshirë në fletëthirrjen për intervistë, në praktikën gjyqësore është arritur në përfundimin se neni 6(3)(a) nuk dikton kritere zyrtare të posaçme lidhur me mënyrën e dhënies së informacionit mbi natyrën dhe shkakun e akuzave (ECtHR, *Pélissier and Sassi v. France*, para.53).

⁵⁴ Shtojca 3 (Transkript i intervistës me datë 17 tetor 2019, Pjesa 1, f.4, rreshtat 21-24).

⁵⁵ Shtojca 3 (Transkript i intervistës me datë 17 tetor 2019, Pjesa 1, f.10, rreshti 18-f.12, rreshti 1).

31. Gjithashtu, në të kundërt të pretendimit të parashtruesit se ai nuk ishte në gjendje të merrte këshillat e duhura prej mbrojtësve,⁵⁶ pasi i kishte dhënë fillimisht parashtruesit të gjithë informacionin e lartpërmendur, ZPS-ja u ofroi konkretisht parashtruesit dhe dy mbrojtësve të tij mundësinë e ndërprerjes së intervistës që ata të këshilloheshin privatisht. U theksua se ata lirisht mund të bënin pushim që do të zgjaste aq sa ishte e nevojshme për këshillimin, duke shënuar se kishte kohë më se të mjaftueshme, duke qenë se intervista ishte planifikuar të vazhdonte edhe ditën e nesërme.⁵⁷ Megjithëse mbrojtësit e parashtruesit pranuan në intervistë se u ishte dhënë informacioni i kërkuar,⁵⁸ ata refuzuan të merrnin një pushim më të gjatë se pesë minuta dhe kur u kthyen konfirmuan se do të ushtrohej e drejta e heshtjes.

32. Për të gjitha këto arsye, pretendimi i parashtruesit duhet të hidhet poshtë.

IV. KLASIFIKIMI

33. Në pajtim me kërkesën referuese dhe vendimin përmbledhës,⁵⁹ kjo përgjigje dorëzohet për protokollim si dokument publik. Gjithashtu në pajtim me kërkesën referuese, shtojcat dorëzohen për protokollim si konfidenciale për të mbrojtur ndër të tjera privatësinë e anëtarëve të personelit të identifikuar me emër të cilët marrin pjesë në kryerjen e hetimeve aktuale.

V. MASA NDREQËSE QË KËRKOHET

34. Për arsyet e lartpërmendura, paneli duhet ta hedhë poshtë kërkesën referuese.

⁵⁶ Kërkesa Referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para 2.10, 4.7, 5.4.

⁵⁷ Shtojca 3 (Transkript i intervistës me datë 17 tetor 2019, Pjesa 1, f.12, rreshtat 20-24 ('ne jemi të gatshëm të bëjmë pushim në çfarëdo kohe, përfshirë edhe që tani, për t'ju dhënë kohë të këshilloheni me njëri-tjetrin për këtë. Ne kemi planifikuar -- kjo intervistë është planifikuar të vazhdojë për pjesën e mbetur të ditës sot dhe nesër. Dhe nëse ju duhet më tepër kohë për t'u këshilluar, ju lutem përdoreni tani. Këshillohuni me klientin tuaj.'). f.13, rreshtat 3-5 ('Merrni sa kohë t'ju duhet, ju lutem. Atëherë, do të bëjmë një pushim të shkurtër që të këshilloheni. Ose një pushim të gjatë, si të dëshironi.')

⁵⁸ Shtojca 3 (Transkript i intervistës me datë 17 tetor 2019, Pjesa 1, f.12, rreshtat 3-4 ('Ky është pikërisht informacioni që ju kërkuam në kërkesën që ju dërguam.')).

⁵⁹ Përmbledhje e vendimit lidhur me kërkesën e Prokurorisë për riklasifikimin e parashtrimit KSC-CC-2019-07/F00001, KSC-CC-2019-07/F00007, 20 nëntor 2019 ('Përmbledhje e vendimit'), f.2.

Numri i fjalëve në origjinal: 4,397

/nënshkrim/

Xhek Smith

Prokuror i Specializuar

E hënë, 2 dhjetor 2019

Në Hagë, Holandë